

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaRapid®-2

AKSELERATOR PËR MPIKSJEN E BETONIT DHE LLAÇIT



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaRapid®-2 është aditiv i lëngshëm për përshejtimin e mpiksjes dhe zhvillimin e rezistencave të hershme pa ndikuar në rezistencën përfundimtare

PËRDORIMET

SikaRapid®-2 është i përshtatshëm për aplikime ku kërkohet mpiksje e hershme e shpejtë dhe zhvillimi i hershëm i rezistencave

- beton i parafabrikuar
- beton i gatshëm
- beton ose llaç i përzierë në vend
- beton i prodhuar në kallëpe të lëvizshme

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Kompatibël me superplastifikuesit
- Shton rezistencën midis 6–24 orësh
- Zgjat rezistencën “green strength”
- Përshejton mpiksjen në temperatura të ulëta
- Rezistencë më e shpejtë ndaj ngricës
- Disarmim më i shpejtë nga kallëpi
- Heqje më herët të membranave të trajtimit
- Lehtësi në ngarkim
- Redukton kërkesat për trajtim me nxehtësi ose avull
- Pa ndikim negativ tek rezistenca përfundimtare
- Nuk përmban klorure
- I përshtatshëm për beton të armuar

MIRATIME / STANDARDE

Plotëson kërkesat e EN 934-2 tabela 6

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Përzierje e agjentëve kompleks organik dhe inorganik
Ambalazhi	fuçi, IBC, rifuxho
Paraqitja / Ngjyra	Lëng i verdhë i tejdukshëm
Jetëgjatësia	12 muaj në konteinerin original të pahapur
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në kushte të thata dhe të freskëta midis 5°C dhe 25°C i mbrojtur nga rrezatimi drejtpërdrejtë diellor dhe ngrirja
Dendësia	~1,34 kg/l
Vlera e pH	~8,4
Përmbajtja konvencionale në trupa të ngurtë	~48 M-%
Viskoziteti	~10 mPa s në 23 °C
Përmbajtja totale e joneve të klorurit	< 0,1 M-%
Ekivalenti i oksidit të natriumit	< 3,0 % (të peshës së Na ₂ O)

TË DHËNA TEKNIKE

Udhëzime për betonimin

Duhet të ndiqen rregullat standarde të praktikës betonimit të saktë, në lidhje me prodhimin dhe hedhjen e betonit. Duhet të kryhen testime paraprake, sidomos kur përdoret një recetë e re ose kur prodhohen elemente të rinj betoni. Betoni i freskët duhet të trajtohet sipas teknikave të njohura dhe të aplikohet sa më herët të jetë e mundur.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Doza e rekomanduar

1,0–2,0 % për peshë çimentoje

Kufizime

SikaRapid®-2 nuk duhet shtuar në çimento të thatë

UDHËZIME APLIKIMI

MËNYRA E APLIKIMIT

SikaRapid®-2 shtohet në ujin e përzierjes ose shtohet njëkohësisht me ujin e përzierjes në betoniere. Mund të shtoni gjithashtu SikaRapid®-2 në betonin bazë të ngarkuar tek betonierja transportuese në vendin e shkarkimit. Në këtë rast, duhet të mbahet një kohë shtesë përzierjeje prej 1 minute për m³. Betoni duhet të kontrollohet për konsistencë të njëtrajtshme përpara shkarkimit nga betonierja transportuese.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaRapid®-2

Shkurt 2019, Botimi 01.01

021402021000000005

SikaRapid-2-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf

BUILDING TRUST

